



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 85-të, të mbajtur më 12.04.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-2954/1 të datës 02.09.2020, me pretendime për keqpërdorim të besimit nga ana e avokatit nga ///, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me LPKKI nuk ka elemente për veprime kompetente për rastin në fjalë

Në të njëjtën kohë, KSHPK-ja konstatoi se organi tjetër është kompetent për të vepruar, dhe tashmë ka vepruar dhe vendosur sipas kompetencave të sajë

Lënda me numër 12-2954/1 të datës 02.09.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Më datë 02.09.2020, një parashtrues i njohur ka dorëzuar denoncim me pretendime për shpërdorim besimi nga një avokat nga /// dhe është formuar lënda me numër 12-2954/1, datë 09.02.2020.

Në denoncim, parashtruesi thekson se pas një periudhe të gjatë kohore nuk ka marrë përgjigje nga Njësia e Urbanizmit pranë Komunës/// në lidhje me kërkesën për përcaktimin e gjendjes juridike të një objekti të ndërtuar pa leje në fshat. /// të cilën e ka dorëzuar në vitin 2011, nga shefi i njësisë/// është këshilluar që për të përfunduar procedurën e kërkesës më shpejt, të angazhoj dhëndrin e tij - avokatin /// nga // /.

Parashtruesi i denoncimit e angazhoi avokatin ///, nga i cili mori njoftim se procedura do të përfundonte brenda dy muajve, për të cilën kërkoi 2000 euro, të cilat i ishin paguar nga llogaria e personit juridik ///, nga të cilat parashtruesi është pronar dhe menaxher.

Pas një periudhe të gjatë, procedura nuk përfundoi. parashtruesi i është drejtuar avokatit me kërkesën që t'i kthehen fondet, por nuk ka arritur t'i kthejë. Parashtruesi në kërkesë ka

deklaruar se avokati ka kërkuar shumën prej 2000 euro për përfundimin me sukses të procedurës së legalizimit, ndërsa shpenzimet e përfaqësimit të tij janë shlyer shtesë me pagesa në llogarinë e personit juridik ///.

Denoncimi i dorëzuar në KSHPK përmban të dhëna se në vitin 2019 parashtruesi ka dorëzuar një kallëzim penal në Prokurorinë Themelore Publike /// (PTHP ///), e cila me Vendim /// të /// vitit e refuzoi të njëjtën gjë dhe urdhëroi prokurorinë që ta merrte përsipër me padi private nga neni 252 i Kodit Penal për veprën penale “Shpërdorimi i besimit”.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK ka konstatuar se personi i raportuar në rastin nuk është zyrtar në kuptim të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit. Në të njëjtën kohë, në bazë të asaj që thuhet në denoncim dhe pas këqyrjes së dokumentacionit të bashkangjitur, KSHPK-ja ka konstatuar se PTHP /// në lidhje me rastin e përshkruar në denoncim tashmë ka ndërmarrë veprime në përputhje me kompetencat e saj ligjore, pas së cilës ka nxjerrë vendim. Nga aty, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Duke pasur parasysh të theksuarën sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Dorëzuar:

- parashtruesi i denoncimit

Përpiloi:

Miratoi:

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska